

L I G J
Nr.8478, datë 22.4.1999

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË KREDISË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT (IDA), PËR PROJEKTIN E PUNËVE KOMUNITARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e kredisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Zhvillimit (IDA), për projektin e punëve komunitare, nënshkruar më 1.2.1999”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2360, datë 6.5.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

Numri i kredisë 3164 ALB

MARRËVESHJE KREDIE PËR ZHVILLIM MIDIS SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (PROJEKTI I PUNËVE KOMUNITARE)

MARRËVESHJE, datë 1 shkurt 1999 midis SHQIPËRISË (Huamarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

MEQë: (A) Huamarrësi, i kënaqur me përshtatshmërinë dhe përparësinë e Projektit të përshkruar në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, ka kërkuar nga Shoqata që ta ndihmojë në financimin e Projektit;

(B) Projekti do të zbatohet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar (FZSH) me ndihmën e Huamarrësit dhe, si pjesë e kësaj ndihme, Huamarrësi do t’i dorëzojë FZSH fitimet nga Kredia sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje; dhe

MEQë: Shoqata ka pranuar, në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të mësipërme, që t’i akordojë Huamarrësit kredinë sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara në këtë Marrëveshje si dhe në Marrëveshjen e projektit të përfunduar midis Shoqatës dhe FZSH;

PRANDAJ palët kontraktuese bien dakord për sa vijon:

Neni I
Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

Pjesa 1.01. “Kushtet e Përgjithshme që u përkasin Marrëveshjeve mbi Kreditë për Zhvillim” të Shoqatës, nënshkruar më datën 1 janar 1985, ndryshuar më 2 dhjetor 1997, me përmirësimet e bëra më poshtë (Kushtet e Përgjithshme), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje:

(a) është shtuar një paragraf (12) në Pjesën 2.01. që do të lexohet si me poshtë, dhe paragrafët ekzistues nga (12) deri (14) të Pjesës së përmendur për këtë arsye do të numërohen si paragrafë nga (13) deri (15):

12. “Vend Pjesëmarrës” i referohet çdo vendi të kushtëzuar nga Shoqata të plotësojë kërkesat e vendosura në Pjesën 10 të Rezolutes No. 183 të Bordit Udhëheqës të Shoqatës, miratuar më 26 qershor 1996; dhe “Vende Pjesëmarrëse” i referohet, kolektivisht, të gjitha vendeve të tilla.

(b) Fjalja e dyte e Pjesës 5.01. e ndryshuar do të lexohet:

“Përveç kur Shoqata dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, nuk mund të bëhen tërheqje: (a) nga llogaria e shpenzimeve në territoret e çdo vendi që nuk është Vend Pjesëmarrës ose për artikuj të prodhuar në, ose shërbime të ofruara nga, territore të tilla; ose (b) për shkak të çdo pagese personave ose njërive, ose për çdo import mallrash, nëse një pagesë ose import i tillë, sipas dijenisë së Administratorit, është e ndaluar nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i marrë në Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.”

Pjesa 1.02. Përveç rasteve të caktuara, termat e përcaktuara në kushtet e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë përcaktimet e theksuara dhe termat plotësuese që pasojnë kanë këto përcaktime:

(a) “FZSH” i referohet Fondit të Zhvillimit Shqiptar, krijuar si një njësi e pavarur me personalitet juridik në përputhje me Vendimin e Qeverisë No. 427 më 8 Shtator 1994;

(b) “Përfituesi” ose “Përfituesit” i referohet një njësie qeveritare ose jo qeveritare si fshatra, komuna, bashki, ose shoqata që propozojnë të zbatojnë Nën-Projekte sipas Pjesës A të Projektit;

(c) “Nën-Projekt” i referohet një projekti të veçantë zhvillimi që do të zbatohet nga një Përfitues duke shfrytëzuar fitimet e një granti të Pjesës A të Projektit;

(d) “Rregullat dhe Udhëzimet Operacionale” i referohet udhëzimeve që përmbajnë kriteret administrative, financiare, të promocionit, vlerësimit dhe mbikqyrjes që do të ndiqen nga FZSH dhe do të miratohen në përputhje me kushtet e Pjesës 6.01. (b) të kësaj Marrëveshjeje;

(e) “Marrëveshje Projekti” i referohet marrëveshjes midis Shoqatës dhe FZSH, nënshkruar në datën e përcaktuar këtu, dhe kjo mund të plotësohet nga koha në kohë, dhe ky term përfshin të gjitha shtojcat dhe marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së Projektit;

(f) “Marrëveshja Plotësuese” i referohet marrëveshjes që do të përfundohet midis Huamarrësit dhe FZSH në përputhje me Pjesën 3.01. (b) të kësaj Marrëveshjeje, me që kjo mund të plotësohet kohë pas kohe, dhe ky term përfshin çdo shtojcë të Marrëveshjes Plotësuese të Huase; dhe

(g) “Llogari e Posaçme” i referohet llogarisë së përmendur në Pjesën 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Kredia

Pjesa 2.01. Shoqata pranon t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të

përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Dhënies së Kredisë për Zhvillim, një shumë në valutë të monedhave të ndryshme baras me gjashtë milion e pesëqind mijë të Drejta të Posaçme Tërheqëse (SDR 6,500,000).

Pjesa 2.02. (a) Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra (ose, nëse Shoqata pranon të bëhet) për koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga fitimet Kredisë.

(b) Për nevojat e Projektit, Huamarrësi do të hapë dhe do të mbajë një llogari të posaçme në dollarë në Bankën e Shqipërisë me kushte dhe kondita të pranueshme për Shoqatën. Depozitat dhe tërheqjet nga Llogaria e Posaçme do të kryhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Pjesa 2.03. Data e mbylljes është 31 mars 2003, ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Pjesa 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën kryesore të Kredisë së patërhequr nga koha në kohë në një përqindje që do të vendoset nga Shoqata më 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar gjysmë përqindshi ($1/2$ të 1%) në vit.

(b) Pagesa e angazhimit do të fillojë: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (data e shtimit) deri në datat në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) sipas përqindjes së caktuar më 30 qershor menjëherë para datës së fillimit të shtesës ose me një përqindje tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) mësipër. Vlera e caktuar më 30 qershor të çdo vit do të përdoret nga data e ardhshme e pagesës në atë vit të përcaktuar në Pjesën 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë Shoqata; (ii) pa kufizime të çfarëdo lloji që mund të vendosen nga , ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhë të përcaktuar në këtë Marrëveshje për nevojat e Pjesës 4.02 të kushteve të Përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e kësaj Pjese.

Pjesa 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një përqindje prej tre të katërtat e një përqindi ($3/4$ e 1%) në vit të shumës së përgjithshme të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Pjesa 2.06. Pagesat e angazhimit dhe pagesat e shërbimeve do të paguhen dy herë në vit të 1 shkurt dhe 1 gusht të çdo viti.

Pjesa 2.07. (a) në përputhje me paragrafët e mëposhtëm (b) dhe (c), Huamarrësi do të ripaguajë shumën e përgjithshme të Kredisë në pagesa gjysmëvjetore çdo 1 shkurt dhe 1 gusht duke filluar nga 1 shkurt 2009, dhe duke përfunduar më 1 gusht 2038. Të gjitha pagesat deri dhe duke përfshirë pagesën me 1 gusht 2018 duhet të jenë një përqind (1%) të shumës së përgjithshme, dhe çdo pagesë pas kësaj datë do të jetë dy përqind (2%) e shumës së përgjithshme.

(b) Kurdo që: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë i Huamarrësit, i përcaktuar nga Shoqata, tejkalon për tre (3) vite rresht nivelin vjetor të caktuar nga Shoqata për kushtëzimin e përdorimit të burimeve të Shoqatës; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të besueshëm për t'i dhënë kredi, Shoqata, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pasi ata të kenë shqyrtuar zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit, mund të ndryshojë kushtet e ripagimit sipas dispozitave të paragrafit të mësipërm (a):

(A) Duke i kërkuar Huamarrësit të paguajë dyfishin e pagesës derisa të shlyhet e gjithë shumata e Kredisë; dhe

(B) Duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë shlyerjen e shumës së përgjithshme të Kredisë si pagesë e datës së gjysmës së parë të vitit referuar në paragrafin (a) të mësipërm që është gjashtë muaj (6) ose më shumë pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin se kanë ndodhur ngjarjet e theksuara në këtë paragraf (b), duke shtuar se do të ketë një periudhë minimale favorizuese prej pesë (5) vjetësh për këtë pagesë të shumës së përgjithshme.

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund t'i ndryshojë modifikimet referuar në paragrafin (b) më sipër, kështu që në vend të një pjese të pagesës ose të të gjithë shtesës së pagesës, të paguhet interesi me një përqindje vjetore të caktuar me Shoqatën mbi shumën e përgjithshme të Kredisë së tërhequr ose ende të papaguar nga koha në kohë, në qoftë se sipas mendimit të Shoqatës këto shqyrtime nuk do të ndryshojnë elementin e kredisë së dhuruar sipas modifikimeve të pagesës të lartpërmendur.

(d) Në qoftë se në çdo kohë pas modifikimit të kushteve sipas paragrafit (b) më sipër, Shoqata përcakton se gjendja ekonomike e Huamarrësit është keqësuar dukshëm, Shoqata, nëse i kërkohet nga Huamarrësi, mund të bëjë modifikime të tjera të kushteve të pagesës për t'iu përshtatur afatit të caktuar të pagesës siç parashikohet në paragrafin (a) më sipër.

Pjesa 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për nevojat e Pjesës 4.02. të Kushteve të Përgjithshme.

Pjesa 2.09. FZSHH caktohet si përfaqësues i Huamarrësit për nevojat e marrjes së çdo veprimi të nevojshëm ose të lejueshëm sipas kushteve të Pjesës 2.02. të Marrëveshjes dhe nenit V të Kushteve të Përgjithshme.

Neni III Zbatimi i Projektit

Pjesa 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj qëllimeve të Projektit të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim, pa asnjë kufizim ose pengim të detyrimeve të tij të tjera sipas Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim, do të sigurojë që FZSHH do të kryejë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Projektit të gjitha detyrimet e përcaktuara në FZSHH, do të ndërmarrë dhe do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet, përfshirë sigurimin e fondeve, pajisjeve, shërbimeve dhe burimeve të tjera të nevojshme ose të përshtatshme për ta bërë të mundur që FZSHH të kryejë detyrime të tilla, dhe nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që do të parandalonte ose do të ndërhynte në kryerjen e detyrimeve të tilla.

(b) Huamarrësi do t'i verë në dispozicion FZSHH si dhuratë fitimet nga Kredia, sipas një Marrëveshjeje Plotësuese që do të përfundohet midis Huamarrësit dhe FZSHH, sipas kushteve dhe konditave që do të miratohen nga Shoqata.

(c) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas Marrëveshjes Plotësuese në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Shoqatës dhe që do të plotësojë synimet e Kredisë, përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, Huamarrësi nuk do të transferojë, ndryshojë, abrogojë ose heq dorë nga Marrëveshja Plotësuese ose nga ndonjë dispozitë e saj.

Pjesa 3.02. Përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, sigurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimet e këshilluesve të nevojshëm për Projektin dhe që do të financohen nga fitimet e Kredisë, do të kryhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të Marrëveshjes së Projektit.

Pjesa 3.03. për qëllimet e Pjesës 9.07 të Kushteve të Përgjithshme dhe pa asnjë përjashtim përveç kësaj, Huamarrësi do të:

(a) të përgatisë në bazë të udhëzuesve të pranueshme nga Shoqata, dhe të pajisë Shoqatën jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes, ose më vonë së kjo datë siç mund të jetë rënë dakord midis Huamarrësit dhe Shoqatës, më një plan për veprimet e ardhshme të Projektit;

(b) t'i ofrojë Shoqatës një rast të arsyeshëm për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për planin e përmendur;

Pjesa 3.04. Huamarrësi do të sigurojë që FZSHH, deri sa të përfundohet Projekti, do të punësojë një drejtor ekzekutiv, përvoja dhe kualifikimet e të cilit gjithmonë do të jenë të pranueshme nga Shoqata dhe do të këshillohet me Shoqatën përsa i përket zëvendësimit të drejtorit ekzekutiv të FZSHH para se të bëhet një zëvendësim i tillë.

Pjesa 3.05. Përveç se kur Shoqata ka rënë dakord ndryshe, Huamarrësi nuk duhet të përmirësojë ose ndryshojë dhe nuk do të shkaktojë ose mundësojë FZSHH të përmirësojë ose

ndryshojë Rregullat dhe Udhëzuesit Operacionale.

Pjesa 3.06. Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord që detyrimet e përcaktuara në pjesët 9.03, 9.04, 9.05, 9.06, 9.07 dhe 9.08 të Kushteve të Përgjithshme (që kanë të bëjnë me sigurimin, përdorimin e mallrave dhe të shërbimeve, planeve dhe afateve, dokumenteve dhe raporteve, mirëmbajtjen dhe marrjen e tokës, respektivisht) do të kryhen nga FZSH në përputhje me Pjesën 2.03. të Marrëveshjes së Projektit.

Neni IV **Konventat financiare**

Pjesa 4.01. (a) për të gjitha shpenzimet lidhur me të cilat janë bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve, Huamarrësi do të:

(i) do të mbajë ose do të sigurojë mbajtjen në përputhje me praktika të përpikëta kontabiliteti, dokumentet dhe shënimet mbi shpenzime të tilla;

(ii) të sigurojë që të gjitha dokumentet (kontratat, kërkesat, faturat, vërtetimet dhe dokumente të tjerë) që vërtetojnë shpenzimet, mbahen të paktën për një periudhë një vjeçare pasi Shoqata të ketë marrë raportin e revizionit për vitin fiskal në të cilin tërheqja e fundit është bërë nga Llogaria e Kredisë; dhe

(iii) të lejojë përfaqësuesit e Shoqatës që të kontrollojnë dokumentacionin.

(b) Huamarrësi do të:

(i) revizionojë të gjitha dokumentet dhe llogaritë e përmendura në paragrafin (a) (i) të kësaj Pjese dhe ato të Llogarisë së Posaçme për çdo vit fiskal të revizionuar në përputhje me parime të përshtatshme kontabilitetive të përdorura në mënyrë të vazhdueshme, nga revizorë të pavarur e të pranueshëm nga Shoqata;

(ii) të pajisë Shoqatën menjëherë sa të jenë të gatshme, por në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit në të cilin është kryer raporti i revizionit nga revizorët në fjalë, me përmasa dhe hollësi të tilla që i kërkon Shoqata në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë mendimin e pavarur nga revizorët në fjalë nëse deklaratat për shpenzimet të paraqitura gjatë vitit të tillë fiskal, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme të përdorura në përgatitjen e tyre, mund të jenë bazë për të vërtetuar tërheqjet përkatëse; dhe

(iii) pajisë herë pas herë Shoqatën me informacione të tjera lidhur me dokumentet, llogaritë dhe revizionet e përmendura në përputhje me kërkesat e arsyeshme të Shoqatës.

Neni V **Masat që mund të marrë Shoqata**

Pjesa 5.01. në përputhje me Pjesën 6.02 (1) të Kushteve të Përgjithshme një ngjarje tjetër është specifikuar, përkatësisht, që Rregullat dhe Udhëzuesit Operacionale janë ndryshuar, pezulluar, abroguar, tërhequr ose nxjerrë jashtë përdorimit ose është nxjerrë ndonjë dispozitë ligjore që do të ndikonte materialisht dhe negativisht, sipas mendimit të Shoqatës, në zbatimin e Projektit.

Pjesa 5.02. Në përputhje me 7.01. (h) të Kushteve të Përgjithshme, ngjarjet e tjera të mëposhtme janë specifikuar, përkatësisht, që do të ndodhë ngjarja e përcaktuar në Pjesën 5.01 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni VI **Data e Hyrjes në Fuqi, përfundimi**

Pjesa 6.01. Ngjarjet që pasojnë janë përcaktuar si kushte shtesë për efektshmërinë e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim në kuadër të përcaktimit të Pjesës 12.01. (b) të Kushteve të Përgjithshme.

(a) Marrëveshja Plotësuese është ekzekutuar nga ana e Huamarrësit dhe FZSH;
(b) Rregulloret dhe Manualët Vepruese janë miratuar nga FZSH në formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Shoqata; dhe

(c) Vendimi i Qeverisë No. 427 datë 8 shtator 1994 është ndryshuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave në përmbajtje dhe formë të pranueshme nga Shoqata.

Pjesa 6.02. Çështjet e mëposhtme që janë përcaktuar si shtesë brenda kuptimit të Pjesës 12.02. (b) të Kushteve të Përgjithshme, do të përfshihen në opinionin ose opinionet me të cilat do të pajiset Shoqata:

(a) që Marrëveshja e Projektit është autorizuar ose ratifikuar nga Huamarrësi dhe FZSH dhe i është detyruar ligjërisht FZSH në përputhje me kushtet e saj; dhe

(b) që Marrëveshja Plotësuese është autorizuar ose ratifikuar nga Huamarrësi dhe FZSH dhe i është detyruar ligjërisht Huamarrësit dhe FZSH në përputhje me kushtet e saj.

Pjesa 6.03. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e Pjesës 12.04 të Kushteve të Përgjithshme

Neni VII

Përfaqësuesi i Huamarrësit, Adresat

Pjesa 7.01. Përveç siç është dhënë në Pjesën 2.09 të kësaj Marrëveshjeje, Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Pjesës 11.03. të Kushteve të Përgjithshme.

Pjesa 7.02 Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e Pjesës 11.01. të Kushteve të Përgjithshme:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tirana
Albania
Teleks:
4295 Komplan AB
Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa telegrafikeTeleks
INDEVAS 248423 (RCA)
Washington, D.C. 82987 (FTCC)
64145 (WUI) ose
197688 (TRT)

PARA DëSHMITARëVE, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në distriktin Columbia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lartshënuar për herë të parë.

SHQIPëRIA
Nga Pandeli Majko
Përfaqësuesi i Autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE TË PËR ZHVILLIM
Nga A.Hartmann
Nën Presidenti Rajonal
Për Europën dhe Azinë Qendrore

SHTOJCA 1
TËRHEQJA E FITIMEVE TË KREDISË

Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e treguesve që do të financohen nga fitimet e Kredisë, shpërndarjen e shumës së Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për treguesit që do të financohen në çdo Kategori:

Kategoria Shuma e Kredisë % e shpenzimeve
së Alokuar për t'u financuar
(shprehur në
SDR të baras
vlefshme)

- (1) Punime publike në
Pjesën A të Projektit 4,550,000 90%
- (2) Shërbimet e
këshilluesve, studime
dhe kualifikime sipas
Pjesës B dhe C të
Projektit 800,000 100%
- (3) Pajisje sipas Pjesës B
dhe C të Projektit 80,000 100% të shpenzimeve të huaja, 100% të shpenzimeve lokale
(kostoja jashtë fabrikës) dhe 85% të shpenzimeve lokale për artikuj të tjerë të prokuruar në vend.
- (4) Kosto operacionale
e shtuar 400,000 100%
- (5) të paalokuara 670,000

TOTALI 6,500,000
=====

2. Për nevojat e kësaj Shtojce:

(a) termi “shpenzime të huaja” u referohet shpenzimeve në monedhën e çdo vendi tjetër përveç asaj të Huamarrësit për mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga territori i çdo vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit;

(b) termi “shpenzime lokale” u referohet shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat ose shërbimet e furnizuara nga territori i Huamarrësit; dhe

(c) termi “ shtesë e koston operacionale” u referohet shpenzimeve të koston operative dhe të mirëmbajtjes të cilat nuk kishin ndodhur pa Projektin dhe në to përfshihen, ndër të tjera, kostot për: (i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të prokuruar ose të përdorura për Projektin; (ii) pagat e personelit të FZHS, përveç atyre të punonjësve publikë të marrë për nevojat e

Projektit; (iii) pajisje konsumi për zyrat.

3. Pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 mësipër, asnjë tërheqje nuk mund të bëhet për: (a) pagesa për shpenzime të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje; dhe (b) shpenzime në Kategorinë (1) për Pjesën A të Projektit, nëse këto shpenzime nuk janë bërë në përputhje me procedurat dhe sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të cilave i referohet Shtojca 2 e Marrëveshjes së Projektit.

4. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga Llogaria e Kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzimet e kontratave për: (i) punime që nuk e kalojnë vlerën \$ 150,000; (ii) mallra që nuk e kalojnë vlerën e barasvlefshme me \$ 50,000 ; (iii) firma këshilluese që nuk e kalojnë vlerën e barasvlefshme me \$ 100,000 dhe për këshillues individual që nuk e kalojnë vlerën e barasvlefshme me \$ 30,000; dhe (iv) studime, kualifikime dhe shtesën e kostos operacionale, sipas kushteve dhe konditave të tilla që do të përcaktojnë Shoqata pas lajmërimit nga Huamarrësi.

SHTOJCA 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Synimet e Projektit janë : (a) të lehtësojë ngushtimet në infrastrukturën e vogël duke rehabilituar infrastrukturën e vogël sociale dhe ekonomike të qëndrueshme në përputhje me prioritetet e zhvillimit të pushteteve dhe komuniteteve lokale; dhe (b) të ngrejë aftësinë e komuniteteve lokale dhe pushteteve lokale për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal.

Projekti përbëhet nga pjesët që vijojnë, të cilat mund të modifikohen me marrëveshje midis Huamarrësit dhe Shoqatës nga koha në kohë për të arritur synimet:

Pjesa A: Programi i Punëve të Infrastrukturës

Parashikimi i granteve për nën-projekte, për Përfituesit, ndër të tjera: (a) rehabilitim rrugësh, (b) riparim ose zgjerim i sistemeve të ujësjellësave; (c) riparim dhe ndërtim shkollash e qendrash shëndetësore dhe ndërtesa të tjera publike; dhe (d) krijim ose rehabilitim të tregjeve.

Pjesa B: Aftësia Ndërtuese e Pushtetit Lokal dhe Komunitetit

Parashikim për shërbime kualifikimi dhe këshillimi teknik për stafin e pushtetit lokal dhe komuniteteve, ndër të tjera, vlerësim nën-projekti, zbatim dhe mirëmbajtje; njohuri ambientale; dhe prokurim. Krijimi i një qendre të dhënash dhe informacioni për aktivitetet e zhvillimit lokal.

Pjesa C: Zhvillimi institucional

Përmirësimi i aftësisë institucionale të FZSHH në, ndër të tjera, të krijojë një sistem të tij të informacionit, të revizionojë dhe të vlerësojë rezultatit e operacioneve të tij, dhe identifikojë, përgatisë, vlerësojë, mbikqyrë dhe nxisë Nën-projektet, me ndihmën e asistencës teknike, kualifikimeve dhe pajisjeve të FZSHH.

* * *

Projekti parashikohet të përfundojë deri më 30 shtator 2002.

SHTOJCA 3 LLOGARIA E POSAÇME

1. Për nevojat e kësaj Shtojce:

(a) termi “Kategoritë e përshtatshme” u referohet Kategorive (1) deri (4) të përcaktuara në tabelë në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) termi “shpenzime të përshtatshme” u referohet shpenzimeve që i përkasin kostos së arsyeshme të punimeve, mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin dhe që do të financohen nga fitimet e Kredisë të alokuara kohë pas kohe në Kategoritë e përshtatshme në

përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje; dhe

(c) termi “Alokimi i autorizuar” i referohet një shumë të barasvlefshme me \$ 800,000 që do të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë dhe depozitohet në Llogarinë e Posaçme në përputhje me paragrafin 3 (a) të kësaj Shtojce.

2. Pagesa nga Llogaria e posaçme do të bëhet vetëm për shpenzime të përshtatshme në përputhje me dispozitat e kësaj Shtojce.

3. Pasi Shoqata ka marrë të dhëna të kënaqshme për të, që Llogaria e posaçme është hapur, tërheqjet nga Alokimi i Autorizuar dhe tërheqjet e pastajme për të mbuluar Llogarinë e Posaçme do të kryhen si vijon:

(a) Për tërheqjet nga Alokimi i Autorizuar, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës një kërkesë ose kërkesa për një depozitë ose depozita që nuk kalojnë shumën e përgjithshme të Alokimeve të Autorizuara. Në bazë të një kërkesë ose kërkesash të tilla, Shoqata, në emër të Huamarrësit do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e Posaçme një shumë ose shumën e tilla që Huamarrësi do të ketë kërkuar.

(b) (i) Për rimbushjen e Llogarisë së Posaçme, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës kërkesa për depozita në Llogarinë e Posaçme në intervale të tilla që do t'i përcaktojë Shoqata.

(ii) Para ose në kohën e secilës kërkesë, Huamarrësi do t'i dorëzojë Shoqatës dokumente dhe të dhëna të tjera të nevojshme sipas paragrafit 4 të kësaj shtojce për pagimin ose pagesat në raste kur kërkohet rimbushja e llogarisë. Në bazë të çdo kërkesë të tillë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga llogaria e Kredisë dhe do të depozitojë në Llogarinë e Posaçme po atë shumë që do të ketë kërkuar Huamarrësi dhe që do të jetë përcaktuar nga dokumentet e përmendura dhe të dhënat e tjera se është paguar nga Llogaria e Posaçme për shpenzime të përshtatshme.

Të gjitha depozitat e tilla Shoqata do t'i tërheqë nga Llogaria e kredisë sipas Kategorive përkatëse të përshtatshme, dhe në shumën përkatëse të barasvlefshme siç do të jetë justifikuar nga dokumentet e përmendura dhe të dhënat e tjera.

4. Për çdo pagesë të Huamarrësit nga Llogaria e Posaçme, Huamarrësi, në atë kohë që Shoqata do të ketë bërë kërkesë të arsyeshme, do t'i dorëzojë Shoqatës dokumente dhe të dhëna të tjera që provojnë se pagesa të tilla janë bërë vetëm për shpenzime të përshtatshme.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të kësaj Shtojce, Shoqatës nuk duhet t'i kërkohet të bëjë depozita të tjera në Llogarinë e Posaçme:

(a) në qoftë se, ndonjëherë, Shoqata do të ketë vendosur që të gjitha tërheqjet e tjera duhet të kryhen nga Huamarrësi drejtpërdrejtë nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe paragrafit (a) të Pjesës 2.02. të kësaj Marrëveshjeje;

(b) në qoftë se Huamarrësi nuk do të ketë pajisur Shoqatën, brenda periudhës së përcaktuar në Pjesën 4.01.(b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e revizionit të kërkuara nga Shoqata në përputhje me Pjesën e përmendur përse i përket revizionit të dokumenteve dhe llogarive për Llogarinë e Posaçme;

(c) në qoftë se, ndonjëherë, Banka do të njoftojë Huamarrësin për qëllimin e tij për të pezulluar në rësisht ose pjesërisht në drejtën e Huamarrësit për të bërë në rreheqje nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Pjesës 6.02. të Kushteve të përgjithshme; ose

(d) kur shumën e përgjithshme të patërhequr e Kredisë së alokuar në Kategoritë e përshtatshme, minus shumën e papaguar të ndonjë angazhimi të posaçëm nga Shoqata në përputhje me Pjesën 5.02. të Kushteve të Posaçme në rastin e Projektit, do të jetë i barabartë me ekuivalentin dyfish të shumës së Alokimit të Autorizuar. Pastaj tërheqja nga llogaria e Kredisë e shumës së mbetur pa tërhequr nga Kredia e Alokuar në Kategoritë e përshtatshme do të ndjekë ato procedura që Shoqata do t'i përcaktojë me shkrim Huamarrësit. Tërheqje të tilla të tjera do të kryhen pas dhe në atë masë që Shoqata do të jetë e kënaqur se shumën e tilla ende të mbetura në depozitë në Llogarinë e Posaçme deri në datën e njoftimit do të përdoren për pagesa për shpenzime të përshtatshme.

6. (a) Në qoftë se Shoqata në çdo kohë do të vendosë që çdo pagesë nga Llogaria e

Posaçme: (i) është bërë për një shpenzim ose të një shume në kundërshtim me dispozitat e paragrafit 2 të kësaj Shtojce; ose (ii) nuk është justifikuar nga të dhënat e dorëzuara në Shoqatë, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata: (A) në pajisë të dhëna shtesë siç mund t'i kërkojë Shoqata; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë e Posaçme (ose, në rast se Shoqata bën kërkesë, do t'ia kthejë Shoqatës) një shumë baraz me shumën e pagesave të tilla ose të një pjese të saj të pakualifikuar ose justifikuar. Vetëm në qoftë se Shoqata pranon ndryshe, asnjë depozitë tjetër nuk do të bëhet në Llogarinë e Posaçme deri sa Huamarrësi të japë të dhëna ose të bëjë depozita ose pagesa, si të jetë rasti.

(b) Në qoftë se Shoqata do të ketë vendosur në çdo kohë se çdo shumë ende e papaguar në Llogarinë e Posaçme nuk do të jetë e nevojshme për të mbuluar pagesat e mëtejshme për shpenzimet e përshtatshme, Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Shoqata, do t'i kthejë Shoqatës shumën që ende nuk është paguar.

(c) Huamarrësi, pas njoftimit nga Shoqata, i kthen Shoqatës të gjitha ose pjesë të fondeve në depozitë në Llogarinë e Posaçme.

(d) Rikthimi i fondeve Shoqatës sipas dispozitave të paragrafëve 6 (a), (b) dhe (c) të kësaj Shtojce do t'i kreditohen Llogarisë së Kredisë për tërheqjet e mëvonshme ose për përfundimin e tyre në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë Kushtet e Përgjithshme.